



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

RAPORT INDIVIDUAL PËR KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR BARAZINË GJINORE”

1. Titulli i Projektaktit:

“Për miratimin e projektligjit “Për barazinë gjinore”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi për Projektligjin “Për barazinë gjinore, është Postuar me 10.03.2025 dhe Data e Mbylljes : 07.04.2025.

Numri i Shikimeve 1394

Numri Komenteve 1

3. Metoda e konsultimit:

Metodat e konsultimit të përdorura në procesin e projektligjit “Për barazinë gjinore”, janë publikimi i projektligjit “Për barazinë gjinore” në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit Publik, takime dhe Ëorkshope konsultative të drejtpërdrejta dhe online, të realizuar me:

- Anëtarë të Grupit të punës / Urdhër Ministri 39/2024;
- Antarët e Grupit të interesit, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe agjencive të UN në Shqipëri;
- Përfaqësues nga sektori privat i grave dhe vajzave sipërmarrëse;
- Përfaqësues nga Forumi i Mediave;
- Publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimin Publik të MSHMS:

Projektligji për “Për barazinë gjinore” është publikuar në faqen zyrtare <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/826>.

Në vijim, MSHMS-ja ka bashkërenduar të gjithë procesin konsultativ përmes reflektimit të mendimeve dhe kontributeve të dhëna për Ligjin për Barazinë Gjinore, duke përgatitur relacionin përfundimtar të projektligjit për miratim në Këshillin e Ministrave.

Porçesi i Konsultimit sipas takimeve dhe ëorkshopeve përkatësisht, si më poshtë:

- ✓ **17 Korrik 2024**, MSHMS / Drejtoria e Barazisë Gjinore zhvilloi takimin e parë të punës me anëtarët e Grupit të Punës, të ngritur me Urdhër Ministri nr. 39, datë 24.01.2024, përfaqësues të ministrisë së linjës, (*institucione në nivel qendror dhe varësisë*).

Qëllimi i Takimit konsultues: Prezantimi i hapave që do të ndiqen në vijim në procesin e hartimit të ndryshimeve në ligjin Për barazinë gjinore, sugjerimet për ndryshime të

nevojshme bazuar në raportet kombëtare dhe ndërkombëtare, për përafrimin e legjislacionit me të BE-së.

Në datë 22 Korrik 2024, MSHMS / Drejtoria e Barazisë Gjinore zhvilloi takimin konsultues me përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile me përvojë të spikatur në fushën e barazisë gjinore.

Qëllimi i Takimit konsultues: Ndarja e sugjerimeve dhe rekomandimeve nga përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile Për ligjin për barazinë gjinore.

- ✓ **11 Shtator 2024**, MSHMS / Drejtoria e Barazisë Gjinore zhvilloi takimin e e radhës konsultues mbi projektligjin Për barazinë gjinore me përfaqësues të grave dhe vajzave nga sektori privat i sipërmarrjes dhe biznesit.

Qëllimi i Takimit konsultues: Prezantimi i dispozitave të cilat prekin drejtëpërdrejt sektorin privat lidhur me kuotat gjinore në nivelin drejtues në fushën e biznesit, dhënia e mendimeve dhe rekomandimeve mbi dispozitat normative të masave të përkohshme dhe masave të përhershme.

- ✓ **16 Shtator 2024**, MSHMS / Drejtoria e Barazisë Gjinore zhvilloi takimin konsultues të radhës me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe partnerë ndërkombëtare.

Qëllimi i Takimit konsultues: Prezantimi i punës dhe procesit konsultues me të gjithë aktorët e përfshirë në proces, dhe ndryshimet dhe shtesat në 31 nene dhe shtimin e 17 neneve të reja.

- ✓ **03 Tetor 2024**, MSHMS / Drejtoria e Barazisë Gjinore zhvilloi takimin konsultues të radhës me grupet e interesit nga Media forum.

Qëllimi i Takimit konsultues: Prezantimi i strukturës së projektligjit të ri Për barazinë gjinore, roli i medias dhe dispozitat ligjore të cilat prekin veprimtarinë e mediave sa i përket promovimit të barazisë gjinore.

- ✓ **10 Prill 2025**, MSHMS / Drejtoria e Barazisë Gjinore zhvilloi takimin e dytë konsultues me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Qëllimi i Takimit konsultues: Prezantimi i Draft-projektligjit pas reflektimit të komenteve dhe rekomandimeve të mbledhura gjatë procesit konsultues me grupet e interesit.

4. Palët e interesit të përfshira:

Institucionet me përfaqësues si anëtarë të Grupit të Punës / Urdhër Ministri nr.39, datë 24.01.2024.

Shkresa zyrtare Nr.443 Prot, datë 24.01.2024, lënda: “Cakim përfaqësuesi”, drejtuar institucioneve anëtare të Grupit të Punës, bazuar në Urdhrin e Ministrit nr. 39/2024, si më poshtë):

- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Ministër Shteti për Pushtetin Vendor;

- Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin;
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive;
- Instituti i Statistikave;

Institucione si palë interesi të përfshira në dhënie kontributi në hartimin e projektligjit ‘Për Barazinë Gjinore’, drejtuar për mendim përmes Shkresës zyrtare Nr.1797 prot, datë 22.04.2025, si më poshtë:

- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Industrisë dhe Energjitikës;
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Minister Shteti për Pushtetin Vendor;
- Minister Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin;
- Minister Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin;
- Minister Shteti dhe Kryenegociatori;
- Minister Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit;
- Minister Shteti për Rininë dhe Fëmijët;
- Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;
- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- Avokati i Popullit;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive;
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Instituti i Statistikave;
- Departamenti i Administratës Publike;

Përfaqësues të ftuar, pjesëmarrës në takimet e konsultimit parapërgatitor, si më poshtë:

- 9 Institucione në nivel qendror/varësi;
- 18 përfaqësues të **OJF-ve**, (qendra sociale ditore dhe rezidenciale), shoqata të shoqërisë civile dhe grupe interesi aktive në fushën e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut;
- 5 Organizatë Ndërkombëtare (UNDP, UN Women, UNICEF, UNOPS, IOM).
- 7 përfaqësues të Ambasadave dhe Agjencive Ndërkombëtare (Ambasada Suedeze, Ambasade e Vendeve të Ulta, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, GIZ, OSCE, AICS, ADA)

Agjencia e Kombeve të Bashkuara UN Women, mundësuan mbështetjen me ekspertë në hartimin e projektligjit ‘Për barazinë gjinore’.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Formatet në të cilat u kryen takimet konsultative përgjatë procesit të hartimit të projektligjit ‘Për barazinë gjinore’, janë të drejtpërdrejtë (*fizike*).

Komentet, mendimet, idetë dhe sugjerimet janë marrë gjatë takimeve konsultative si dhe dërguar me shkrim në formë shkresore dhe formë elektronike (sistemi elektronik i akteve).

Gjithashtu, MSHMS sqaron se projektakti i ligjit ‘Për barazinë gjinore’ është miratuar në datë 11.07.2025 në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore.

Në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, janë regjistruar 1,403 shikime/vizitorë dhe është postuar 1 koment nga Komiteti Shqiptar i Helsinikit.

MSHMS-ja ka bashkërenduar të gjithë procesin konsultativë përmes reflektimit të mendimeve dhe kontributeve të dhëna për hartimin e projektligjit ‘Për barazinë gjinore’, strategjisë kombëtare për barazinë gjinore 2021-2030, rekomandimet dhe konventat ndërkombëtare të GREVIO, CEDAE dhe Konventën e Stambollit si dhe Direktivat e Acquis në fushën e barazisë gjinore, duke përgatitur relacionin përfundimtar të projektligjit për miratim në Këshillin e Ministrave.

Nga sugjerimet e bëra nga shoqëria civile u morën parasysh dhe u pasqyruan në text rreth 12 komente si vijon:

Nr.	Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Organizata		Koment Kryesor		Reflektimi në Projektligj	

Aleanca LGBTI	Zgjerimi i përkufizimit të “gjinisë” duke u parë në lenten e gjithëpërfshirjes, përtej konceptit binar burrë-grua.	U reflektua në nenin 4 pika 1 germa ë) me një përkufizim gjithëpërfshirës të konceptit “gjinia”
Shoqata për Autonominë Vendore	-Përfshirja e përfaqësuesve të pushtetit vendor në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore. -Qartësi në metodologjinë e raportimit dhe të dhënave gjinore në nivel vendor	Thirrja e përfaqësuesve të pushtetit vendor në mbledhjet e KKBGJ është reflektuar në Nenin 17 pika 3. Rekomandimi lidhur me vendosjen e një metodologjie të qartë u morr në konsideratë dhe u reflektua në nenin 21 pika 1 germa c.
Projekti “Bashki të Forta” – HELVETAS	Përfshirje më e fuqishme e pushtetit vendor në KKBGJ dhe mbledhjen e të dhënave në nivel bashkie	U reflektuan në Nenin 17 pika 3 dhe 21 pika 1 germa c.
Qendra AËEN	Koncept më i qartë për përkufizimet e përfaqësimit të barabartë gjinor, mpuna e papaguar dhe gjuha e ndjeshme gjinore. Të përfshihen OSHC në procesin e monitorimit të ligjit.	Reflektuar në nenin 4 pika 1 germa përkufizimi”: “Përfaqësimi i barabartë gjinor” është përfaqësimi i secilës prej gjinive, në të gjithë diversitetin e tyre, në mënyrë të barabartë dhe asnjëherë me jo më pak se 30 deri në 50 përqind sipas përcaktimit në këtë projektligj, në terma të aksesit dhe fuqisë së barabartë në të gjitha sistemet e vendimmarrjes (vendimmarrje që zhvillohet përmes proceseve formale dhe joformale në të gjithë sektorët, duke përfshirë por pa u kufizuar në atë politik, publik, ekonomik dhe hapësirën digjitale. Kuptimi dhe elementët e “punës së papaguar” janë reflektuar në Nenin 31. Shpjegimi i gjuhës së ndjeshme gjinore është reflektuar në Nenin 10 dhe Nenin 4 germa 1 shkronja e). Përfshirja e OSHC në monitorimin e zbatimit të ligjit

		dhe implementimin e tij janë reflektuar në nenin 15 pika 2 dhe Nenin 7.
Rrjeti i Grave për Barazi në Vendimarrje	-Neni 21 , Njesitë e Vetëqeverisjes Vendore të kryejnë raporte periodike të përputhshmërisë së zbatimit, ku zbatohen dhe kur nuk ndodh zbatimi. -Në emërimin e administratoreve social në njësitë e qeverisjes vendore, të njihen kutoat gjinore. -Buxhetimi gjinor tek nëpunësi i barazisë gjinore për bashkitë që kanë më pak se 100 mijë banorë, të shtohet një parashikim për rol ose funksion me kohës të pjesshme.	Reflektuar në nenin 21 pika 1 gërma c) kryejnë mbledhjen e rregullt periodike, përpunimin dhe raportimin e të dhënave sipas një metodologjie të unifikuar të ndara sipas treguesve gjinorë të ndërlidhur me tregues të tjerë socialë dhe demografikë; -Koment i reflektuar në nenin 23 pika 1: Përfaqësimi gjithpërfshirës dhe i barabartë gjinor në sistemet e vendimarrjes arrihet nëse sigurohet barazia në masën 50 për qind, duke mos lejuar në asnjë rast përfaqësimin më pak se 30 për qind për secilën gjini, përmes transparencës dhe integritetit në proceset e emërimit dhe përzgjedhjes për pozicionet vendimarrëse dhe në pozicionet drejtuese në nivel vendor, rajonal, qendror dhe ndërkombëtar. Komenti mbi rolin e nëpunësve gjinore në nivel vendor është reflektuar në Nenin 22.
Qendra për Drejtësi Gjinore	Detyrimi i bashkive për zbatim të rekomandimeve nga monitorimi	Reflektuar në nenin 12 pika 2
Nisma për Ndryshim Arsis	Të shihet mundësia për përfshirjen e grave dhe vajzave të reja tek neni mbi masat e vecanta. Të rishikohet Neni 26 “Përgjegjësitë e punëdhënësit” Të shtphen masa positive për djemtë në arsim.	MSHMS sqaron se në kuptim të ligjit, burra dhe gra nënkuputon edhe djem dhe vajza. Komentet e marra janë të gjitha të pasquruara në projektligj.

SCIDEV	Përfshirja e AKSHI dhe AKSK në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore	Reflektuar: Parashikim i mundësisë për pjesëmarrje në nenin 17 pika 3
Qendra Komunitare “Sot për të Ardhmen”	Të përfshihet buxheti i përgjigjshëm gjinor dhe buxheti me pjesëmarrje.	U adresua në nenin 12 (Buxheti i përgjigjshëm gjinor) dhe nenin 4 ku jepet përkufizimi i konceptit të “buxhetimit të përgjigjshëm gjinor”.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ka sjellë mendime me anë të shkresës me Nr. 290 Prot, më datë 04.04.2025.

Nga 20 komente të bara nga Komiteti i Helsinkit 16 u morën parasysh dhe u reflektuan ndërsa për 4 u dhanë sqarimet si vijon pse nuk mund të merren parasysh.

Komentete dhe sugjerimet si më poshtë vijon:

Referuar nenit 3, pika 2 të projekt ligjit, parashikohet: *"Dispozitat e këtij ligji, në asnjë rast nuk interpretohen apo zbatohen si kufizuese të garancive për arritjen e barazisë gjinore, të shprehura në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe acquis të Bashkimit European mbi barazinë gjinore"*.

Nga sa më lart, konstatohet se dispozita ligjore ofron një standard të ngjashëm me atë të parashikuar në nenin 17/2 të Kushtetutës, ku parashikohet që kufizimet nuk mund të tejkalojnë ato të vendosura nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut. Po ashtu, kjo dispozitë është e ngjashme me nenin 53 të KEDNJ, ku parashikohet se: *"Asnjë nga dispozitat e kësaj konvente nuk duhet të interpretohet sikur kufizon ose çënon të drejtat e njeriut dhe liritë themelore që mund të sigurohen nga legjislacioni i çdo pale të lartë kontraktuese, ose nga çdo marrëveshje tjetër në të cilën kjo palë e lartë kontraktuese është palë"*.

Në pamje të parë, duket sikur ka thjesht pohim apo mbivendosje të vlerave të normës ligjore me atë kushtetuese dhe konventore apo pohim të këtyre vlerave në nivel ligjor, dhe nuk ka problematika të nivelit kushtetues. Megjithatë, për ligjvënësin lindin detyrime të veçanta për të siguruar zbatimin korrekt/të saktë të jurisprudences kushtetuese, me qëllim që të eliminohen paqartësitë ose papajtueshmëritë midis frymës së ligjit dhe zbatimit të tij në praktikë dhe ruajtjen e besimit publik të legjislacionit i miratuar." (vendim nr.54, datë 09.07.2024 i Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se ajo në zbatim të nenit 131 të Kushtetutës, nuk kontrollon papajtueshmërinë e ligjeve me Acquis communautaire, pasi ky i fundit nuk është pjesë e legjislacionit të brendshëm. (shih vendimin nr.30, datë 02.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese). Ndaj, për sa kohë që Acquis nuk është pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe pohimi se "dispozitat e këtij ligji në asnjë rast nuk interpretohen apo zbatohen si kufizuese të garancive për arritjen e barazisë gjinore, të shprehura në acquis të Bashkimit European mbi barazinë gjinore", tejkalon kuadrin kushtetues në rendin tonë juridik, i cili njeh detyrimin e zbatimit për marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, kjo pasi Shqipëria është në proces anëtarësimi në BE dhe detyrime ka vetëm për zbatimin e akteve ndërkombëtare, pjesë e legjislacionit të brendshëm, të ratifikuara me ligj, (neni 116/b), që në fakt është shprehur tek pjesa e parë e dispozitës së projekt-ligjit. Në këtë drejtim edhe relacioni i projekt-ligjit është shprehur në mënyrë më korrekte, duke mos reflektuar shprehjen "dhe

acquis të Bashkimit European mbi barazinë gjinore". *(Shqipëria është në proces anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe për rrjedhojë kërkohet përputhshmëri e plotë e legjislacionit, përfshirë edhe rastin e ligjit për barazinë gjinore me Acquis).*

Referuar nenit 3, pika 3 të projekt-ligjit, me këtë përmbajtje: "*Pretendimet për shkelje të rregullave të barazisë gjinore të paraqitura pranë subjekteve publike dhe private, të drejtësisë apo të tjera, sipas kompetencave të parashikuara ligjore, shqyrtohen mbi bazën e parimit se barra për të provuar se faktet e paraqitura nuk përbejnë shkelje të këtij parimi, i përket të paditurit dhe subjektit/eve mbi të cilët bie ky pretendim, si dhe organit/eve vendimmarrëse për pretendime të tilla*", vlerësojmë se nuk kuptohet se cili ka qenë qëllimi lidhur me togfjalëshin "*të drejtësisë apo të tjera*". Në pamje të parë, duket se theksi bie mbi "*organet e drejtësisë ose dhe organe të tjera*", por mund të lexohet dhe si "*pretendime për shkelje të rregullave të barazisë gjinore, të drejtësisë dhe pretendime për shkelje të tjera*". Nëse do të ishte ky interpretim i fundit rasti i të kuptuarit të dispozitës, ne vlerësojmë se lëvizja apo përmbysja e barrës së provës përveç se lidhur me rregullat e barazisë gjinore, nuk mund të përfshijë edhe pretendimet për shkelje të natyrave të tjera, për të cilat ndiqet rregulli procedural se barrën e proves e ka paditësi, pra ai që vë në lëvizje procesin gjyqësor. Edhe Gjykata Kushtetuese ka pohuar se parimi i sigurisë juridike, si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në terësi ose dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme (shih vendimet nr. 24, datë 04.05.2021; nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese). Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (shih vendimet nr. 10, datë 26.02.2015; nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese). Formulimet e normave ligjore nuk duhet ta bëjnë të paqartë dhe të pamundur përcaktimin e kuptimit të tyre. Thënë ndryshe, është e nevojshme gjetja e ekuilibrit të duhur, si rrjedhojë e të cilit grupi i individëve që iu adresohet norma ligjore të mos përfshihet në gjendje pasigurie, ndersa zbatuesit e normës ligjore të ndjekin praktika uniforme në raste të ngjashme. (Shih vendimin nr. 24, datë 04.05.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

Për sa më lart, me qëllim që zbatuesit e normës ligjore të ndjekin praktika uniforme dhe ligji mos ketë vend për interpretime të ndryshme, do duhej rishikuar në drejtim të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë dhe uniformitetit të normës. *(Komenti është pranuar dhe reflektuar).*

Referuar nenit 3, pika 4 të projekt-ligjit, parashikohet se: "*Nuk përbejnë diskriminim Për shkak të gjinisë rastet kur subjektet publike dhe private marrin masa sipas këtij ligji, përfshirë edhe dispozita ligjore, që synojnë përshpejtimin e vendosjes së barazisë faktike gjinore. Këto masa pushojnë së ekzistuari sapo të jenë arritur objektivat e barazisë gjinore, për të cilat janë krijuar*". Në vlerësimin tonë dispozita e sipërcituar ka nevojë të ripunohet, dhe riformulohet, pasi nëse i drejtohet subjekteve publike dhe private, duket se togfjalëshi "*përfshirë edhe dispozitat ligjore*", duhet të hiqet, pasi kjo masë i adresohet Kuvendit në kapacitetin e ligjbërësit, rol të cilin po e ushtron pikërisht me këtë projekt-ligj. Thënë ndryshe, një normë ligjore nuk mund t'i delegojë Kuvendit të drejtën për nxjerrjen e një norme tjetër ligjore, pasi nuk vjen në harmoni me nenin 116 të Kushtetutës. *(Komenti është pranuar dhe dispozita është reflektuar).*

Në veçanti, lidhur me formulimet e parashikuara në nenin 3, pika 5 të projekt-ligjit, i cili parashikon se: *"Ky ligj mbështetet në parimin e sigurimit të aksesit dhe përfitimit të barabartë, pavarësisht përkatësisë gjinore, në shërbimet publike dhe private, përfshirë ato të sistemit të drejtësisë"*, ne vlerësojmë se niset nga premisa jo kushtetuese, mbi dhënien e drejtësisë mbi parime të lidhura vetëm me qasje barazie gjinore. Edhe pse norma duket korrekte në pohimin se shërbimet e drejtësisë mbështeten në parimin e sigurimit të aksesit dhe përfitimit të barabartë, pavarësisht përkatësisë gjinore, në fakt krijon dhe zhbën të gjitha parimet që udhëheqin gjykatat në dhënien e drejtësisë, si sektor që është i ndryshëm nga sektorët e tjerë të dhënies së shërbimeve. Sektori i drejtësisë edhe pse konsiderohet shërbim ndaj qytetarit, bazuar mbi të gjitha parimet mbi të cilat jep drejtësi janë të nivelit kushtetues dhe ligjor të ndërvarura dhe të ndërthurura dhe është gjykata që realizon dhënien e drejtësisë në veshtrim të analizimit dhe interpretimit kushtetues dhe ligjor të gjykimit të rasteve konkrete. *(Komenti u reflektua).*

Lidhur me nenin 4, shkronja "b" të projekt-ligjit, ku parashikohet se: *"Buxhetim i përgjigjshëm gjinor ose buxhetim gjinor"* është mjet për të siguruar që angazhimet e ndërmarra politike për arritjen dhe respektimin e barazisë gjinore nga qeverisja, të reflektohen dhe realizohen në praktikë nëpërmjet buxhetit, vlerësojmë se do duhet të rishikohet fiala "përgjigjshëm".

Referuar relacionit të këtij projekt-ligji, prej vitit 2016 buxheti i përgjigjshëm gjinor është përfshirë në ligjin organik të buxhetit të shtetit, pra duket sikur ka hyrë si terminologji nëpërmjet një ligji tjetër. Në vlerësimin tonë, termi shpjegohet dhe përmbledhet mjaftueshëm me versionin 'buxhetim gjinor', që pasqyron thelbin e konceptit, integrim i perspektivës gjinore në të gjitha politikat buxhetore. *(Termi ose koncepti 'buxhetim i përgjigjshëm gjinor', duhet që qëndrojë. Është përdorur posaçërisht në këtë ligj, i përfshirë në Nenin 12, i titulluar – Buxheti i Përgjigjshëm Gjinor. Ky term siguron harmonizimin me legjislacionin e brendshëm).*

Referuar nenit 4, shkronja 'e' të projekt-ligjit, ku parashikohet se: *"Dhunë, ngacmim ose shqetësim me bazë gjinore"* është çdo formë sjelljeje e padëshiruar, që lidhet me gjininë e një personi dhe ka për qëllim dhe/ose sjell si pasojë cënimin e dinjitetit personal, ose krijimin e një mjedisi kërcënues, armiqësor, poshtërues, përçmues apo fyes, ose që prek në mënyrë jo të barabartë personat e një gjinie dhe përfshin ngacmimin ose shqetësimin seksual", vlerësojmë se duhet riformuluar, pasi koncepti që shpjegohet ka brenda dhe dhunë, ngacmim ose shqetësim me bazë seksuale, i parashikuar në shkronjën 'j', që është ndryshe nga dhuna, ngacmimi, shqetësimi me bazë gjinore. *(Përkufizimet janë në përputhje me Konventën e Stambollit dhe atë të CEDAW, Kodin e Punës dhe Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 'Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, pra, përkufizimet janë në harmoni dhe trajtojnë situata dhe raste të ndryshme. Në variantin e fundit të Projekt-ligjit 'Për barazinë gjinore, përmbajtja e shkronjës 'j' e sipër cituar, gjendet në shkronjën 'k').*

Në nenin 4, shkronja 'h' të projekt-ligjit, parashikohet se: *"Masa për sigurimin e barazisë gjinore"* janë masat e përgjithshme, të veçanta, ose të përkohshme dhe përfshijnë masa ligjore dhe politike, aktivitete, kritere dhe praktika, vendime që synojnë përshpejtimin e vendosjes së barazisë gjinore. Këto masa nuk përbëjnë diskriminim dhe ndërpriten me arritjen e objektivave'. Ne vlerësojmë se masat mund të mos përcaktohen në mënyrë shteruese, pra duke i përkufizuar si masa ligjore dhe politike, aktivitete, kritere dhe praktika, vendime, si dhe duke

shtuar shprehjen 'dhe çdo veprim tjetër i nevojshëm dhe i arsyeshëm në kontekstin e masave'. Po, ashtu tek masat e veçanta në relacion janë vënë edhe programet që në këtë dispozitë nuk gjejnë vend. *(Komenti është reflektuar. Në variantin e fundit të Projekt-ligjit 'Për barazinë gjinore, përmbajtja e shkronjës 'h' e sipër cituar, gjendet në shkronjën 'i').*

Po ashtu, në nenin 4, shkronja 'e' të projekt- ligjit parashikohet se: 'Nëpunës i barazisë gjinore' është punonjësi i Administratës publike, në qeverisjen qendrore apo vendore, përfshirë edhe Kuvendin, që ia kushton kohën e punës arritjes së barazisë gjinore", si dhe në nenin 22 është parashikuar se: 'Në institucionet publike qendrore, Kuvend, si dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore me të paktën 100 000 banorë, emërohet me kohë të plotë të paktën një punonjës/e në pozicionin e nëpunësit të barazisë gjinore'.

Sa më lart, vlerësojmë se do duhet të rishikohen dispozitat lidhur me detyrimin për pasjen e një nëpunësi të barazisë gjinore, ku mund të përfshihen dhe institucione të tjera të pavarura kushtetuese dhe të pavarura të krijuara me ligj, përveç institucioneve të pushtetit ekzekutiv, (organe qendrore dhe vendore), si Kontrolli i Lartë i Shtetit, Komisioneri i Mbikqyrjes së Shërbimit Civil, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit, Autoritete dhe ente të ndryshme publike si ERRE, RTSH, etj. Pra duhet të dalë i qartë koncepti i administratës publike qendrore, pasi në ligje të ndryshme ka përkufizime të ndryshme. (shih KPA, ligjin për administratën shtetërore, ligjin për organet kolegjiale dhe entet publike, ligjin për të drejtën e informimit, etj). *(Komenti është reflektuar. Përkufizimi i referohet administratës publike qendrore dhe vendore, gjë e cila sipas të drejtës administrative përfshin edhe institucione të tjera brenda këtij përkufizimi).*

Në nenin 5, (zbatimi i ligjit), pika 1-3, parashikohen, për sa vijon: '1. Ky ligj mbron nga diskriminimi për shkak të gjinisë të gjithë personat që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me subjektet publike dhe private që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me subjektet publike dhe private që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë'. Për sa më lart, ne vlerësojmë se duhet rishikuar titulli i dispozitës. Konkretisht, nga titulli "zbatimi i ligjit" mund të thuhet "subjektet e mbrojtura nga ligji/subjektet zbatuese të ligjit". Po ashtu në pikën 1, ligji me termin që qëndrojnë në Shqipëri", duket sikur ka qëllime ngushtuese, dhe gjithashtu dhe pikat 2 dhe 3, nuk e zgjerojnë rrethin për personat pa shtetësi. Këto përkufizime, duhet të jenë në harmoni me nenin 3, shkronja 'o', ku i jepet mbrojtje për "të drejtat dhe liritë themelore të një personi apo grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi". P.sh. Ligji për Avokatin e Popullit mbron të gjithë personat pa dallim, për shkelje të pretenduara nga administrata publike, (neni 1), ndaj dhe në këtë kuptim vlerësojmë se ligji i jep mbrojtje të gjithë personave, pavarësisht shtetësisë, vendbanimit, apo vendqëndrimit, dhe duhet riformuluar në këtë aspekt. *(Komenti është reflektuar).*

Në nenin 6, pika 4 të projekt-ligjit, parashikohet se: 'Ndalohet mosmarrja në shqyrtim e një kërkesë ose ankimi, zhvillimi i çfarëdo procedure shqyrtimi për pretendime diskriminimi, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që cenon parimet e barazisë gjinore të parashikuara në këtë ligj ". Ky formulim, duhet riparë në vështrim të nenit 48 të Kushtetutës, i cili sanksion detyrimin për dhënie përgjigjeje nga organet e administratës publike ndaj çdo kërkesë, ankese, vërejtje, në

afatet dhe kushtet e përcaktuara me ligj. Duke marrë në konsideratë që ligji përfshin si subjekte detyruese për zbatim edhe subjektet private, duhet përfshirë detyrimi për dhënien përgjigje edhe për këto institucione private/subjekte private, ndaj duhet të dalë e qartë në formulim. *(Komenti është marrë parasysh dhe dispozita është riformuluar)*

Komenti i bërë për nenin 7 pika ‘f’, është reflektuar sipas komentit të Komitetit të Helsinkit.

Komenti i bërë për nenin 8, pika 4, është reflektuar sipas komentit të Komitetit të Helsinkit.

Komenti lidhur me shkrojtjen ‘d’ dhe ‘e’, u rishikua dhe u reflektua.

Komenti për nenin 17, shkronja ‘h’, dhe Neni 17 pika 6 – rregullat për funksionimin dhe për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjimore, përfaqësuesit nga organizatat jofitimprurëse, do të përcaktohen me VKM.

Komenti për nenin 23 pika 4, nuk pranohet. Koment: Pikërisht këtë stereotip dhe gjendje shoqërore në Republikën e Shqipërisë, kërkojmë ta luftojmë nërmjet këtij ligji, për të mos e lënë situatën në status quo. Do të ishte në kundërshtim me kërkesat që burojnë nga Acquis të Bashkimit Evropian si dhe nga rekomandimet e lëna për shtetin shqiptar nga komiteti CEDAW dhe GREVIO.

Komenti për nenin 25 pika 2, lidhur me diskriminimin për shkak të shtatzanisë,...etj, komenti është reflektuar dhe dispozita është riformuluar.

Komenti për nenin 26 pika 3 dhe 4, për kontratat kolektive, është rregulluar në përputhje me komentet e Ministrisë së Drejtësisë.

Komenti për nenin 45 pika 4, është riformuluar sipas komenteve nga Komiteti i Helsinkit. Komenti për nenin 46, është reflektuar. Komenti për nenin 47, neni është reflektuar sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Komenti për nenin 48 pika 1, është reflektuar dhe riformuluar ‘... në përputhje me dispozitat e KPA-së, apo Kodit të Punës dhe Legjislacionit në fuqi..’. Komenti për nenin 50, komentet janë reflektuar më herët nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.